

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama me shqiptarët në New York: Shqipëria e sotme nuk është më vendi që ka nevojë për ndihma! Projektet për Sazanin e Zvërnecin, të jashtëzakonshëm - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/rama-takim-me-komunitetin-shqiptar-ne-newyork-shqiperia-e-sotme-nuk-eshte-me-vendi-qe-ka-nevoje-per-ndihma-kemi-nisur-krijimin-e-regjistrimit-kombetar-te-diaspores
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 18:31:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 18:31:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8de44c31ee784aa563ad1c3b663cde622e4711c75cc4ae97aff29a89f8a13e4
TEKSTI	64131824c737e487d49104cdde74a1f26d9b681a08feba767aaa615c81b31e94
PAMJA	df3cea6186b34ec43a1aa93e622714244700487acfd74ff6e7d3512949013ca8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	aceb597382ff05f018fdd4c6ede9aa4316c04a949c6657ad4a663fd442068b9a
E MËPARSHMJA	b0321bb24de1accaac9d68e1dc4eaa5183999835755f2a6b73e7d0f58cd4d1f8
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/aceb597382ff05f018fdd4c6ede9aa4316c04a949c6657ad4a663fd442068b9a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Kryeministria: Nesër Edi Rama mesazh shqiptarëve nga Rinas pas kthimit nga New York, për situatën e krijuar në vend



Politikë

Rama me shqiptarët në New York: Shqipëria e sotme nuk është më vendi që ka nevojë për ndihma! Projektet për Sazanin e Zvërnecin, të jashtëzakonshëm

Kryeministri Rama tha se Shqipëria e sotme nuk është si Shqipëria e disa viteve më parë, kur banorët që jetojnë në vend kishin nevojë për ndihmat e shqiptarëve të Diasporës.

■ Rama nga New York: Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare!



Redaksia

26 Shtator, 20:29 | Përditësimi: 26 Shtator, 21:19

Share Tweet



Kryeministri [Edi Rama](#) ka zhvilluar një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New York, gjatë vizitës së tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ka marrë pjesë në Asambleen e Përgjithshme të OKB-së.

Gjatë fjalës së tij para të pranishmëve, Rama tha se lidhja mes Shqipërisë dhe Diasporës është forcuar gjatë viteve të fundit, pasi sipas tij, ka nisur ndërtimi i urave të bashkëpunimit, ku kalojnë interesa e investime.



"Pavarësisht se jemi në [SHBA](#), ky është një territor jo i pushtuar zyrtarisht nga shqiptarët. Në vitin 2015 unë isha në një darkë shqiptarësh i ftuar, sëbashku me Hashim Thaçin dhe në atë darkë u diskutua për herë të parë ideja e atij që një vit më pas u bë Samiti i parë i Diasporës në Tiranë. 10 vite prej atij Samiti, besoj se kanë ndodhur plotë gjëra pozitive dhe lidhja e Shqipërisë me Diasporën është kthyer në një lidhje ku janë ngritur ura që kalojnë interesa, investime dhe plotë rikthime shqiptarësh në tokën ëmë. 90 % e familjeve shqiptare kanë përfituar të paktën njëherë nga dërgesat financiare të shqiptarëve të Diasporës. Ky është një nder i madh që do ta mbulojë me lavdi diasporën shqiptare të gjithë këtyre viteve. Por siç e thashë, nuk jemi më në atë fazë, kur diaspora jepte e [Shqipëria](#) merrte, por jemi në një tjetër fazë.



LEXO EDHE:
Kryeministria: Nesër Edi Rama mesazh shqiptarëve nga Rinas pas kthimit nga New York, për situatën e krijuar në vend

Kemi nisur të krijojmë një regjistër kombëtar të Diasporës, për të gjitha ata që duan të investojnë sadopak në Shqipëri. Ky ndryshim që ka ndodhur në këtë marrëdhënie, s'ka ndodhur thjeshtë aty ku ta rrok syri, por ka ndodhur në mendësi. Tani jeta është shumë më organike dhe pjesë e atij organiciteti ishin edhe vezët që m'u hodhën mua. Madje, një nga hedhësit e vezëve kishte ardhur nga Anglia për të hedhur vezë. Shpresoj të ketë kaluar mirë me Policinë e Nju Jork. Në trupën e mbrojtjes pastaj që u angazhua në çdo event, ishte një shqiptar që shërben në Policinë e Nju Jork. Prandaj unë u ndodha komplet në shtëpi, edhe Policia, edhe protestuesit. Këtu u pritja me një tortë rozë, që kishte 2 flamingo si një zemër. Më erdhi mirë. Shqipëria nuk vuan më tani faktin që zogjtë e kafshët vriten dhe askush nuk shqetësohet për to. Shqipëria e sotme nuk është më Shqipëria në nevojë për ndihma. Sot Shqipëria ka hequr një derë të re, derën e maleve të saj", tha mes të tjerash Rama.

Kryeministri Rama gjatë fjalës së tij foli edhe për turizmin, teksa tha se Shqipëria po synon turizmin e vlerës, për të sjellë në vend pushues që shpenzojnë më shumë.

Duke i cilësuar si të jashtëzakonshëm investimet që pritet të realizohen në [Sazan](#) dhe [Zvërnec](#), Rama tha se po kryhet studim për të vlerësuar risqet që projektet do të sjellin në mjedis.

■ "Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, një projekt që s'ka parë më shumë se 4





Projekt i Sazanit dhe Zvernecit, një projekt që sjell vetëm në Zvernec më shumë se 4 miliardë euro, në një ekonomi që në totalin e vet është 27 miliardë euro. Një projekt i jashtëzakonshëm për Shqipërinë. Është jashtëzakonisht delikat edhe në aspektin e ekuilibrit për mjedisin, prandaj ne po punojmë shumë për të pasur një studim për ndikimin dhe risqet në mjedis. Risqet reale dhe jo ato që prodhohen në rrjetet sociale nga sharlatanët e manipulatorët”, shtoi Rama.

Lajm në përditësim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: [Të Fundit](#)

Ora 20:45

Rama nga New York: Projekti i Sazanit dhe Zvernecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare! Po studiojmë risqet që mund të sjellë në mjedis

Kryeministri Edi Rama ka zhvilluar ditën e sotme një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New York.

Gjatë fjalës së tij para të pranishmëve, Rama tha se Shqipëria po synon turizmin e vlerës, me qëllim sjelljen e më shumë përfitimeve ekonomike për popullin shqiptar.

Rama përmendi edhe investimet që pritet të realizohen në ishullin e Sazanit dhe në Zvernec të Vlorës, ku tha se vetëm në Zvernec do të investohen 4 miliardë euro, një shumë që sipas kryeministrit është tepër e lartë për ekonominë shqiptare.

Ai shtoi se Qeveria po studion edhe dëmin që këto projekte mund të sjellin në mjedis, duke hartuar një studim të plotë mbi risqet reale.



“Këtë synim ka projekti i shumëdiskutuar, projekti i famshëm, por edhe fatkeq për fat të keq, si rezultat i shumë gënjeshtreve, manipulimeve, denigrimeve. Projekti i Sazanit dhe Zvernecit, një projekt që sjell vetëm në Zvernec më shumë se 4 miliardë euro, në një ekonomi që në totalin e vet është 27 miliardë euro. Një projekt i jashtëzakonshëm për Shqipërinë. Është jashtëzakonisht delikat edhe në aspektin e ekuilibrit për mjedisin, prandaj ne po punojmë shumë për të pasur një studim për ndikimin dhe risqet në mjedis. Risqet reale dhe jo ato që prodhohen në rrjetet sociale nga sharlatanët e manipulatorët. Shpresoj që kur të vini në Shqipëri, kryepolici të na japë mundësi që të takohemi. Para se të vija këtu, më mori në telefon Dritani nga Mali i Zi, ish-kryeministri dhe miku im i shtrenjtë, i vetmi qytetar i botës në Ballkan, i cili më tha 'shiko se atje ku po shkon, te ajo dallga shqiptare, ke edhe disa shkurme nga Ulqini. Kështu që shumë faleminderit”, tha mes të tjerash Rama.

R.Xh/Shqiptarja.com

[f Share](#)

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG:

[edi rama](#)

[SHBA](#)

[diaspora shqiptare](#)

[shqiperia](#)

[New York](#)

[sazan](#)

[zvernec](#)

[resorti ne zvernec](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



[LAJMET MË TË VLERËSUARA](#)

Komente

[Komento](#)

Tani:

26/09/2026 21:06

As shqip nuk din me fol, as fjalën shqip reazione nuk di me e perdor por thet risqet. 4 miliard euro beton e na thot qe jane due u bere studime

[Përgjigju](#)

Legeni:

26/09/2026 21:01

O Rame mos u merr shume me zvernecin dhe sazanin se jane per bukurri por shiko te degjeneruarit me te cilet drejton shtetin. Idiot

[Përgjigju](#)



Sondazhi i ditës:

Ambasadori i ri i SHBA nis misionin, a besoni se do sjellë ndryshim në mjedisin politik?

26 Shtator, 18:15

Po

Jo

Disi

Lajme të tjera



Rama nga New York: Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare! Po studiojmë risqet që mund të sjellë në mjedis

26 Shtator, 20:45



Thoma Gëllçi: Predikimi në shkretëtirë -Parodi-



Thoma Gëllçi

26 Shtator, 19:26



'Joe Biden dhe SHBA e tradhtuan Thaçin'- Blushi reagon pas deklaratave të Ramës: Hamendësime! Kryeministri s'ka lëvizur as gishtin e vogël për të nxitur njohjen e Kosovës

26 Shtator, 18:02



Hoxha nënshkruan Konventën e OKB kundër Krimit Kibernetik: Siguria, pjesë e axhendës kombëtare të transformimit digjital të Shqipërisë

26 Shtator, 15:29



Berisha: Arrestimi i ish-kreut të SHISH, më i rëndë se i çdo zyrtari! Fjalimi i Ramës në OKB turp, nuk foli për UÇK

26 Shtator, 14:35



Ndjekësi në vështirësi Berishën: A je ftuar nga ambasadori amerikan? Kreu i PD pa ftesë: S'kam dijeni për ceremoninë (VIDEO)

26 Shtator, 12:55



I pandehur në Rumani, lidhjet e ish-numrit 2 të inteligjencës rumune me Vlora Hysenin! Media: Coldea ishte këshilltar i Ramës, ndanë të njëjtën zyrë

26 Shtator, 10:57



Trump refuzon propozimin e Iranit për armëpushim, pritet të rifillojë bombardimet pas zgjedhjeve të nëntorit

26 Shtator, 08:27



SHBA 3 vite pa ambasador në Tiranë, Eric Wendt nis misionin! Ambasada: Do të çojë para prioritetet e Trump! Begaj: Partneriteti, i pazëvendësueshëm (VIDEO)



Isa Myzyraj

26 Shtator, 07:39



SHBA/ Gjykata Supreme i lejon Trumpit të përdorë bazën e të dhënave 'kontroverse' për të kontrolluar shtetësinë e votuesve

25 Shtator, 22:52



'Shteti është i gjithë shqiptarëve, jo i socialistëve'- Sula zbulon në Report Tv bisedat me Ramën para se të merrte detyrën: S'jam 'diamant', por kam qëndruar larg interesave personale

25 Shtator, 21:32



Fjala e PLOTË/ Edi Rama në OKB: Makinaria e Inteligjencës Artificiale do të bindet, pyetja është 'kujt'



Edi Rama

25 Shtator, 20:49

[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[**Shqiptarja.com**]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.